

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“GDS COMPANY” SH.P.K

Ortakët themelues:

- **Z. Francesco Ardizzoni** shtetas italian, i datëlindjes 23/04/1996, lindur në Ferrara (FE), banues në Rrugën Azimut, nr.23, Ferrara , Itali, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës italiane Nr. YB7841666
- dhe
- **Z. Enrico Blo** shtetas italian, i datëlindjes 10/06/1994, lindur në Ferrara (FE), banuese në Rrugën Barlaam 21, Ferrara, Itali, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës italiane Nr. YB9819131

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot më datë 08.04.2024, hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1
Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “**GDS COMPANY**” SH.P.K Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2
Forma

Shoqëria tregtare “**GDS COMPANY SH.P.K** ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3
Zyra Qendrore

3.1. Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**GDS COMPANY**” SH.P.K, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Donika Kastrioti 3, Kisha Apostolike e Re, Hyrja 2, Kati i 1, Apt.1, Nr.1, Tirane, Shqipëri.

3.2. Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4
Objekti i Veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë: Projektimi, idealizimi dhe realizimi i krijimeve website, krijimi i rendereve fotorealiste, animacioni multimedial, menaxhimi i rrjeteve sociale të korporatave, dizajni grafik i logove, kurse kompjuterike, dizajni grafik për rrjetet sociale, rekomandime përmes sistemit kompjuterik, krijimi i programeve kompjuterike, aktivitete të tjera të lidhura për IT, përpunimin e të dhënave kompjuterike.



NENI 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

NENI 6
Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare “GDS COMPANY” SH.P.K mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brënda dhe jashtë vendit.

NENI 7
Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “GDS COMPANY” SH.P.K. Përgjegjësia e ortakëve është e kufizuar në vlerën e aksioneve që ata kanë kontribuar në shoqëri.

NENI 8
Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1. Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “GDS COMPANY” SH.P.K është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortakët e ndarë në 2 pjesë:

Z. Francesco Ardizzoni – 1 kuotë – 50% me vlere 50.000 (pesëdhjetë mijë lekë)
dhe

Z. Enrico Blo – 1 kuotë – 50% me vlere 50.000 (pesëdhjetë mijë lekë)

NENI 9
Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10
Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Francesco Ardizzoni**.

NENI 11
Sekreti tregtar

Ortakët, administratorët dhe punëmarrësit e shoqërisë “GDS COMPANY” SH.P.K përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.




NENI 12
Mosmarrëveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim.
Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

Francesco Ardizzoni

francesco ardizzoni 

Enrico Blo

Enrico Blo 